



**Rregullore e Programit të Nivelit të parë të Studimit në: Bachelor në Ekonomiks**

1. Dispozita të Përgjithshme

1. Kjo rregullore bazohet në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Udhëzimin e MASH, për celjen e Programeve të Studimit.
  1. Të drejtën e kontrollit akademik mbi këtë strukturë akademike e ka Përgjegjësi i Departamentit, Dekani i Fakultetit, Përgjegjësi i Degës Mësimore, Zv.Rektori akademik dhe Rektori i UV.
  2. Të drejtën e kontrollit administrativ dhe financiar mbi këtë strukturë akademike e ushtron Dekani i Fakultetit, Kancelari dhe Rektori i UV.
  3. Financimi i programit të studimit Diplomë e Nivelit të Parë në Ekonomiks realizohet nga tarifa e shkollimit të studentëve, nga burime financiare brenda Universitetit "Ismail Qemali" dhe/ose nga burime jashtë tij, bashkëpunuese në këtë program studimi.
  4. Kohëzgjatja e programit të studimit Diplomës së Nivelit të Parë në Ekonomiks është tre vite akademik, në përfundim të të cilit studenti fiton 180 kredite akademike (ECTS).
  5. Regjistrimet në programin e Diplomes së Nivelit të Parë në Ekonomiks bëhen vetëm mbi bazën e një diplome në Shkollën e Mesme të Përgjithshme ose Profesionale.
  6. Përzgjedhja e kandidatëve në Diplomën e Nivelit të Parë në Ekonomiks, bëhet në bazë të Procedurave të vendosura nga MASH, për maturën shtetërore.
  7. Frekuentimi i aktiviteteve formuese të programit të studimit Diplomë e Nivelit të Parë në Ekonomiks është i detyrueshëm në masën 80% për seancat brenda auditorit (leksione, seminare) dhe në masën 100% për praktikën profesionale (laboratore, etj.).
  8. Të gjitha lëndët e parashikuara në planin mësimor shlyhen me provim në semestrin përkatës.
  9. Praktika profesionale do të realizohet pranë qendrave të prodhimit, bizneseve dhe ndërmarrjeve të ndryshme.
  10. Përpara marrjes së Diplomës së Nivelit të Parë në Ekonomiks realizohet provimi final me mbrojtje para Komisionit të Diplomimit të një punimi.
  11. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diploma: Diplomë e Nivelit të Parë në Ekonomiks" sipas modelit bashkëngjitur këtij dokumentacioni.
  12. Diploma e Nivelit të Parë në Ekonomiks firmoset nga Koordinatori i Komitetit Shkencor, njëherësh edhe Kryetar i Komisionit të Diplomimit, Dekani i Fakultetit dhe Rektori i Universitetit "Ismail Qemali".
  13. Diplomat e Nivelit të Parë në Ekonomiks, përpara se të lëshohen nga Universiteti "Ismail Qemali", duhet të regjistrohen në regjistrin shtetëror të Diplomave dhe Çertifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, që mbahet në MASH, në bazë të Nenit 31 të Ligjit për Arsimin e Lartë.
2. Struktura Akademike Pergjegjese per organizimin dhe menaxhimin administrativ e financiar te programit te studimit eshte Komiteti Shkencor, i zgjedhur nga Fakulteti i Ekonomise, perberja e te cilit u citua me lart.